

**AKT THEMELIMI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"MANTOVANI - BETON M.B."  
SH. P. K.  
SHKODER**

Ne baze te ligjit 7512 dt. 10. 8. 1991 "Per sanksionimin e mbrojtjen e prones private e privatizimit, te ligjit nr. 7638 date 19. 11.1992 "Per shoqerite tregtare", dhe te ligjit nr. 7667 date 28. 1. 1993 "Per rregjistrimin e shoqerive ne rregjistrin tregtar", me vullnetin tim te lire, te shprehur ne nenshkrimin e ketij akti, ne, 1. Mark Pieter Curri, dtl. 10 Janar 1968, lindur e banues ne Rrence, Shkoder, dhe 2. Bardh Gjon Zefi, dtl. 28 Shkurt 1969i, kemi krijuar shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "Mantovani - Beton M.B." Sh.p.k., Shkoder, me administratore dhe ortakë 1. Mark Curri dhe 2. Bardh Zefi, secili me nga  $\frac{1}{2}$  pjese te kuotave te kapitalit themeltar(secili me nga 50.000 leke te reja).

**OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

Objekti i veprimtarise ekonomike te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Mantovani - Beton M.B." sh.p.k., Shkoder, eshte :

Prodhim e tregtim, me shumice dhe pakice, eksport-import, i artikujve te ndryshem industrial; ushqimore; ushqime per blegtorine; konfeksione; makineri e paisje; te paisjeve elektro-shtepiake; hidro-sanitare; materiale e lende ndertimi; prodhim e tregtim te materialeve te ndertimit; prodhime bujqesore e blegtorale, bime medicinale; mobileri; agjensi turistike, Tregtim me pakice karburante e lubrifikante; transport per vehte e te trete.

**SELIA E SHOQERISE.**

Selia e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Mantovani - Beton M.B." Sh.p.k. Shkoder, eshte ne Rrence, Shkoder.

**KOHEZGJATJA**

Jetegjatesia e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Mantovani - Beton M.B." Sh.p.k. Shkoder, eshte mbi 10 vjet. Ajo mund te shperndahet me vendim te Asamblese se Ortakëve te shoqerise, ose te autorizuarve prej saj, kur i autorizuari ka prokure te posaçme per shperndarjen e shoqerise.

**KAPITALI THEMELOR OSE PJESET**

Kapitali themelor i shoqerise "Mantovani - Beton M.B." Sh.p.k., Shkoder, eshte 100.000 leke, duke patur administratore dhe ortake 1. Mark Curri dhe 2. Bardh Zefi, secili me nga  $\frac{1}{2}$  pjese te kuotave te kapitalit themeltar (secili me nga 50.000 leke te reja).


Per te sanksionuar veprimtarine e vet, si dhe maredheniet e punes ne te gjithë fushat e saj, shoqeria do te kete e do te çele librin e saj, qe quhet "Libri i Shoqerise".

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "Mantovani - Beton M.B." Sh.p.k., Shkoder, do te kete dhe do te mbaje llogarine e saj, duke u mbeshtetur tek leku shqiptar dhe valutat e huaja.

Maredheniet e punes ne shoqeri, do te rregullohen nepermjet kontrates se punes. Per çeshtjet qe nuk rregullohen me kontraten e punes, ato do te rregullohen ne baze te legjislacionit ne fuqi, me vendim te Asamblese se Ortakeve, gjithmone sipas legjislacionit ne fuqi per kete çeshtje.

Kjo kontrate, pasi u lexue me ze te larte, u firmos nga administratoret dhe ortaket e shoqerise "Mantovani - Beton M.B." Sh.p.k., Shkoder :

1. Mark Curri




2. Bardh Zefi



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E DREJTESISË  
DHOMA NOTERISE SHKODER

Nr.rep. 2107




#### AUTENTIFIKIM NENSHKRIMI

Ne Dhomen e Noterise Shkoder, dhe para meje noter Arben Salim Kopliku, sot me dt. 17 Nentor 2004(dymije e kater), u paraqiten personalisht z. z. 1. Mark Pjeter Curri, dtl. 10 Janar 1968, lindur e banues ne Rrence, Shkoder, dhe 2. Bardh Gjon Zefi, dtl. 28 Shkurt 1969, lindur e banues si siper, per identitetin e te cileve jam i njohur personalisht, madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar, me kerkese te tyre, vertetoj nenshkrimet e hedhura me siper:

Arben Salim Kopliku

Noter



## S T A T U T

### I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "MANTOVANI - BETON " SH. P. K. SHKODER

#### NENI 1

#### EMERTIMI

Ne baze te ligjit 7512 dt. 10. 8. 1991 "Per sanksionimin e mbrojtjen e prones private e privatizimit, te ligjit nr. 7638 date 19. 11.1992 "Per shoqerite tregtare", dhe te ligjit nr. 7667 date 28. 1. 1993 "Per rregjistrimin e shoqerive ne rregjistrin tregtar", me vullnetin tim te lire, te shprehur ne nenshkrimin e ketij akti, ne, 1. Mark Pieter Curri, dtl. 10 Janar 1968, lindur e banues ne Rrence, Shkoder, dhe 2. Bardh Gjon Zefi, dtl. 28 Shkurt 1969, kemi krijuar shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "Mantovani - Beton M.B." Sh.p.k., me administratore dhe ortake 1. Mark Curri, 2. Bardh Zefi, secili me nga  $\frac{1}{2}$  pjese te kuotave te kapitalit themeltar(secili me nga 50.000 leke te reja).

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "Mantovani - Beton M.B." Sh.p.k. Shkoder, fiton personalitetin juridik nga dita e rregjistrimit te saj ne Gjykatën e Rrethit te Tiranes. Ajo eshte person juridik shqiptar, dhe e zhvillon aktivitetin e vet ne perputhje me normat e legjislacionit shqiptar ne fuqi, dhe aktet e saj themeluese, si ky statut, si dhe kontrata qe i bashkohet dhe perben nje pjese te pandare te tij.

#### NENI 2

#### OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarise ekonomike te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Mantovani - Beton M.B." sh.p.k., Shkoder, eshte :

Prodhim e tregtim, me shumice dhe pakice, eksport-import, i artikujve te ndryshem industrial; ushqimore; ushqime per blegtorine; konfeksione; makineri e paisje; te paisjeve elektro-shtepiake; hidro-sanitare; materiale e lende ndertimi; prodhim e tregtim te materialeve te ndertimit; prodhime bujqesore e blegtorale, bime medicinale;

mobileri; agjensi turistike, Tregtim me pakice karburante e lubrifikante; transport per vehte e te trete.

### NENI 3

#### SELIA E SHOQERISE.

Selia e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Mantovani - Beton M.B." Sh.p.k. Shkoder, eshte ne Rrence, Shkoder.

Aktiviteti i shoqerise do te zhvillohet ne rrethin e Shkodres, por ai do te shtrihet ne te gjithë territorin e Repubikes se Shqiperise, si dhe jashte saj. Qendra e shoqerise, qe eshte ne seline e sipertreguar, eshte e rregjistruar ne librin e shoqerise "Mantovani - Beton M.B." Sh.p.k. Shkoder. Kjo shoqeri mund te hape filiale te saj ne rrethe te ndryshme te vendit, apo dhe jashte, duke zbatuar te gjithë legjislacionin ne fuqi te vendeve ku do te hapen.

### NENI 4

#### KOHEZGJATJA

Jetegjatesia e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Mantovani - Beton M.B." Sh.p.k. Shkoder eshte mbi 10 vjet. Ajo mund te shperndahet me vendim te Asamblese se Ortakeve, ose te autorizuarit prej tij, kur i autorizuari ka prokure te posaçme per shperndarjen e shoqerise, ose shperndarjen e saj e percakton legjislacioni ne fuqi.

### NENI 5

#### KAPITALI THEMELOR

Kapitali themelor i shoqerise "Mantovani - Beton M.B." Sh.p.k. Shkoder eshte 100.000 leke, qe vjen nga kontributet e ortakeve te shoqerise.

### NENI 6

#### KUOTAT OSE PJESET

Administratoret dhe ortaket Mark Curri dhe Bardh Zefi kane secili nga 50 % ( $\frac{1}{2}$  pjese) te kuotave te kapitalin themeltar(secili me nga 50.000 leke te reja).

Ndryshimi i mases se kapitalit themelor, si per shtimin apo per pakesimin, e tij, behet me vendim me Asamblese se Ortakeve.

Transferimi i tyre behet me akt noterial, ku ka qendren shoqeria. Te tretet i nenshtrohen rregullave te shit-blerjes.

## NENI 7

### DREJTIMI I SHOQERISE

Organi me i larte i shoqerise eshte Asamblea e ortakeve.

## NENI 7/1

### KOMPETENCAT E ASAMBLESE SE ORTAKEVE DHE DHENIA E VENDIMEVE

Asamblea e Ortakeve drejton me vendime dhe ka keto kompetenca:

- Te marre vendime dhe te beje ndryshimet e nevojshme ne statut.
- Te zgjeroje ose te kufizojte kompetencat e administratores se saj.
- Vendos per shperndarjen, ndarjen ose bashkimin e shoqerise.
- Ushtron te gjitha kompetencat qe i njej ligji dhe statuti per ceshtje te vecanta.

Te gjitha vendimet e Asamblese se Ortakeve do te hidhen ne proces verbale nga nje person i caktuar nga ortaket, dhe nenshkruar nga secili prej tyre.

## NENI 8

### ADMINISTRIMI

Shoqeria do te administrohet nga dy administratoret e saj. Administratoret jane organi administrativ i Shoqerise.

## NENI 9

### KOMPETENCAT E ORGANIT ADMINISTRATIV

Kompetencat e organit administrativ caktohen nga statuti, vendimet e asamblese dhe ligji.

Organi administrativ ka kompetenca te gjera, qe perfshin te gjitha veprimtarine e zakonshme dhe te jashtezakonshme te shoqerise, si dhe gjithçka qe parashikohet ne ligj.

Organi administrativ ka keto kompetenca:

- Te marre pjese ne ankande.
  - Te perpiloje kontrata dhe çdo akt tjeter juridik , te çdo lloji qofshin, qe kanë te bejne me veprimtarine e shoqerise.
  - Te perfaqsoje shoqerine ne te gjithë strukturat shoqerore dhe gjyqsore, ne te gjithë shkallet e ne te gjithë llojet, duke mbrojtur interesat e shoqerise.
  - Te emeroje nepunes te rangjeve te ndryshme.
  - Te hapë llogari rrjedhese ne Bankat e Shqiperise, apo dhe jashte saj.
  - Te ndermarre reciprocitete financiare dhe hipotekuese, te marre pjese ne sipermarrje te tjera financiare te te gjithë llojeve.
  - Te bleje, te kembeje e te tjetersoje pasuri te ndryshme qe i sherbejne shoqerise.
  - Te marre ne pune dhe persona te tjere si specialiste etj., gjithmone me kontrate pune.
  - Te marre pjese, n.q.s. eshte e nevojshme, ne procedurat e falimentimit.
- Ky percaktim eshte rregull jo taksativ dhe nuk e kufizon fuqine e ketij organi.

## NENI 10

### PERFAQSIMI

Perfaqsimi i shoqerise perballe te tretteve eshte e drejte dhe detyre e administratoreve te saj.

Administratoret jane pergjegjes para shoqerise dhe te tretteve si per shkeljet ligjore, shkeljet e statutit, ose per fajet e kryera nga ata gjate administrimit te shoqerise.

## Neni 11

Per rastet kur e kerkon ligja, dhe kur e shikon te domosdoshme shoqeria, kontrolli i saj do te kryhet nga nje ekspert kontabel, i ngarkuar per kete qellim.

Eksperti merret ne pune nga administratorja e shoqerise, ose nga i autorizuari prej saj.

## NENI 12

Te gjithë te punesuarit ne këtë shoqeri jane te detyruar te ruajne sekretin e shoqerise gjate dhe ne rast se largohen nga puna.

## NENI 13

SHPERBERJA E SHOQERISE

Shperberja e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Mantovani - Beton M.B." Sh.p.k. mund te vije ne çdo kohe dhe per çfaredo shkak, si per humbje te kapitalit te shoqerise, pamundesi veprimtarie, me vendim te Asamblese se ortakeve te shoqerise, apo kur e parashikon ligja.

## NENI 14

Me shperberjen e shoqerise caktohen nje ose disa likuidatore, duke ju caktuar detyra konkrete, ne radhe te pare per likuidimin e personave te trete, duke percaktuar dhe burimet e likuidimit.

## NENI 15


Persa nuk eshte shprehur ne kete statut, i referohet plotesimeve qe do te beje Asambleja e Ortakeve.

## NENI 16

Ky statut u firmos rregullisht nga ortaket e shoqerise "Mantovani - Beton M.B." Sh.p.k., Shkoder :

## Ortaket

1. Mark Curri



2. Bardh Zefi

